



Datë: 23.12.2025
Numër Protokolli: 8071/2025

A.nr.1884/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1884/2025, të datës 07.11.2025, të parashtruar nga ankuesi S.M nga Ranillugu, kundër organit të punësimit: Komunës së Ranillugut, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1884/2025, e datës 07.11.2025, e parashtruar nga ankuesi S.M.

II. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Ranillugut, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke përsërit kërkesën te Thesari i Kosovës për kompensimin e mjeteve materiale për ankuesin.

III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që në pajtim me kërkesën e pranuar nga Komuna e Ranillugut të bëjë kompensimin e mjeteve materiale për ankuesin.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi S.M (*tutje referuar ankuesi*), më datë 07.11.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli:7220/2025, nën shenjë 1884/2025, lidhur me mos ekzekutimin e pagesës për kompensim sipas Marrëveshjes së datës 03.02.2025 për vëllim të shtuar në pozitën e Zyrtarit Kryesor Financiar, të Komunës së Ranillugut.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën

21.11.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Ranillugut, ndërsa kjo e fundit me datë 11.12.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

s

Kryetari i Këshillit, me datë 17.12.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:7929/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.1884/2025 të datës 07.11.2025 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7220/2025 të datës 07.11.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 21.11.2025 me korrespondencën e bashkangjitur; Përgjigje në ankesë e datës 11.12.2025; Marrëveshja e datës 03.02.2025; Akt Emërimit e datës 12.04.2016; Vendimin e datës 14.01.2025; Marrëveshja e datës 10.09.2025; Shkresë “garanci financiare” e datës 08.09.2025; Formularin për ndryshime të pagës i datës 10.02.2025; Përgjigja e thesarit e muajit shkurt; E-mailin e datës 12.08.2012 dërguar nga N.A për Thesarin e Kosovës; Formularin për ndryshime të pagës i datës 10.02.2025; Përgjigja e thesarit e muajit shkurt; Formularin për ndryshime të pagës i datës 07.10.2025; Kërkesa e ankuesit e datës 05.09.2025; Emaili i datës 17.12.2025 dërguar nga Këshilli për M.C; Përgjigja e datës 17.12.2025 M.C për Këshillin; Vendimin me shifër VK/2025 të datës 17.12.2025.

Kolegji i Këshillit bazuar në legjislacionin përkatës që rregullon çështjen që ndërlidhet me objektin e kësaj anekse si dhe duke marrë për bazë shkresat e lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi është i punësuar në Komunën e Ranillugut, sipas Aktit të Emërimit Nr.01-222/2016 të datës 12.04.2016 në pozitën “Zyrtar i Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale”, ndërsa me datë 14.01.2025 përmes vendimit me shifër Nr.01-013/2025 e ka caktuar ankuesin me detyra shtesë në pozitën e “Zyrtarit Kryesor Financiar” me arsyetimin se zyrtari që mban pozitën në fjalë është në pushim mjekësor, ndërsa me datë 03.02.2025 organi i punësimit, respektivisht ankuesi ka lidhur marrëveshjen për vëllim të punës me Kryetarin e Komunës, në kohëzgjatje prej një (1) viti, dhe atë që nga data 15.01.2025 e deri më datë 15.01.2026, marrëveshje kjo e cila është zgjatur duke u lidhur edhe një marrëveshje tjetër me datë 10.09.2025 e së njëjtës natyrë me kohëzgjatje nga data 10.09.2025 e deri me datë 10.09.2026.

Sipas shkresave të lëndës organi i punësimit me datë 10.02.2025 e kishte përcjellë në Thesarin e Kosovës formularin për ndryshimin e pagës (prej 20%), mirëpo Thesari i Kosovës iu kishte kthyer përgjigje se formulari nuk është plotësuar qartë duke udhëzuar organin e punësimit se si të veprohet për çështjen në fjalë.

Ankuesi për shkak të mos kompensimit nga ana e organit të punësimit, me datë 05.09.2025 i është drejtuar me kërkesë Kryetarit të Komunës së Ranillugut si dhe Drejtorit për Buxhet dhe Financa, kurse Drejtori për Buxhet dhe Financa me datë 08.09.2025 ka nxjerrë shkresën e garancisë financiare përmes së cilës ka konfirmuar se ekzistojnë mjetet e nevojshme monetare për kompensimin e ankuesit dhe mbi këtë bazë me datë 07.10.2025 është nxjerrë formulari për dërgimin e ndryshimeve në pagën e ankuesit për Thesarin e Kosovës, mirëpo nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesi nuk e ka pranuar kompensimin e kërkuar, këtë çështje e konfirmon edhe organi i punësimit, madje në shkresën e datës 09.12.2025 të dërguar në Këshill nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Ranillugut konfirmohet gatishmëria e tyre për kompensimin e

ankuesit lidhur me pagesën për vëllim e shtuara sipas marrëveshjeve respektive, mirëpo theksojnë faktin se kanë paqartësi lidhur me kërkesat e Thesarit.

Ankuesi, për shkak të mos ekzekutimit të kompensimit material sipas konfirmimit dhe përcaktimit nga organi i punësimit, me datë 07.11.2025 ka parashtruar ankesë në Këshill me pretendimin ankimor se nuk është duke u ekzekutuar vendimi i organit të punësimit lidhur me të drejtën e njohur për kompensim sipas Marrëveshjes fillestare të datës 03.02.2025 dhe asaj të datës 10.09.2025, më kërkesën për kompensim në mënyrë retroaktive dhe atë që nga data 03.02.2025 sipas vlerës prej 20% pagës në baza mujore, duke vazhduar tutje sipas marrëveshjes në fuqi të datës 10.09.2025.

Thënë si më lartë, pas konstatimit të dhënë si më lartë në arsyetimin këtij vendimi, lidhur me rrethanat juridike të krijuara, analizoi dhe mori përbazë dispozitat e aplikuara nga neni 8 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“1. Menaxhimi i marrëdhënies së punës së nëpunëses/it civil, nëpunëses/it të shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it të artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknike dhe mbështetëse, bazohet në parimin e ligjshmërisë, integritetit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë partiake dhe mos diskriminimit”*, ndërlidhur me nenin 22 nga i njëjti ligj, Kolegji i Këshillit konstatoi se nëpunësi civil gëzon të drejtën e pagës për orët e kryera në punë, çështje të tilla, ngjashëm i ka rregulluar edhe legjislacioni i aplikuar në kohë, prandaj meqenëse edhe organi i punësimit qëndron prapa zotimit për kompensim e shumës përkatëse, ankesa e ankuesit është aprovuar si në dispozitivin e këtij vendimi.

Andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se duke u bazuar në obligimet ligjore të cekura si më lartë dhe obligimeve të dala nga vendimet përfundimtare, atëherë Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Ranillugut, është e obliguar që sipas dispozitivit të këtij vendimi, ta përsërisë kërkesën për kompensim për pagat e papaguara për ankuesin dhe të njëjtën ta adresoj në Thesarin e Kosovës, ndërsa Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës krahas nenit 97 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është i obliguar që në pajtim me vendimin e cekur më lartë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të marrë parasysh kërkesën e Komunës së Ranillugut me qëllim të zbatimit të saj dhe kompensimin sipas kërkesës për ankuesin.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1884/2025, datë 23/12/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit S.M;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Komunës së Ranillgut (Kryetarit të Komunës dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore) si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK- së.